

Albatrit Bytyçi¹

UDC:

346.14:621.311(497.115)

**PARASHKRIMI I KËRKESAVE PERIODIKE, PAS PRANIMIT TË
BORXHIT TË PARASHKRUAR –
(Rasti KEK-konsumator sipas Ligjit Nr. 04/L-077 të
Marrëdhënieve të Detyrimeve – LMD-së)**

**ЗАСТАРУВАЊЕ НА ПЕРИОДНИТЕ БАРАЊА, ПО
ПРИФАЌАЊЕ НА ЗАСТАРЕНИОТ ДОЛГ-
(Случај КЕК - потрошувач според Закон бр. 04 / L-077 за
облигациони односи - ЛМД)**

**THE PRESCRIPTION OF THE PERIODIC REQUESTS, UPON
RECEPTION OF THE PRESCRIBED DEBTS –
(The case study KEC – Customers pursuant of Law No.
04/L-077 over the Liability Relation – LLR)**

Abstract

Legal Entities enter into different juridical-civil relations in order to regulate the socio-economic relations they entail. Deriving from the following relations, the same ones, generate, change, or terminate any legal liability - contractual agreements. The following relations also have the time limits, within which, each legal entity shall exercise its subjective right within the timeframe. A contrario, after the deadline, not only that it terminates the right of one of the requesting subjects, but also the right of the opponent is gained for the other liable subject. Accordingly, so it happened with the Kosovo Energetic Cooperation (KEC) against its customers (natural and legal persons). Nonetheless,

¹Albatrit Bytyçi – Post graduate student on civil - law module at the Law Faculty of University of Prishtina, Hasan Prishtina”. albatrit4@gmail.com.

regarding these claims, KEC restored them thanks to a legal work camouflaged and stimulated by Law no. 05 / L-043 over the Public Debt Relief and Law no. 05 / L-119 on Amending and Supplementing the Law no. 05 / L-043 on the Public Debt Relief. Upon the re-emergence of these claims, now comes a new term of prescription from the previous one, for which the courts of fact in Kosovo are facing this challenge on how to make their new calculation based on these contracts that KEC customers have accepted a debt that was once was prescribed.

Key words: Kosovo Energetic Cooperation (KEC), customers (natural and legal persons), request, prescription, calculation, contract, debt, term.

SHQYRTIME HYRËSE

Kohëve të fundit gjykatat e faktit në Kosovë janë duke u përballur me disa lëndë të natyrës përmbartimore, ku palë procedurale janë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), në cilësinë e kreditorit si dhe konsumatorët e ndryshëm, në cilësinë e debitorëve. Këto lëndë po derivojnë si shkak i borxheve të akumuluar nga konsumatorët (*personat fizikë dhe juridikë*) që kanë pasur kundrejt KEK-ut, për konsumimin e energjisë elektrike. KEK-u kërkesat e veta nuk i ka realizuar me kohë, prandaj, me kalimin e kohës, edhe i ka humbur. Por, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike dhe të Ligjit Nr. 05/L-119 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike, shumë subjekte të së drejtës u janë drejtuar zyra të kësaj Korporate për të hartuar kontrata me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve. Fatkeqësisht, kjo nuk ishte falje, por ishte e kundërta, pasi që KEK-u borxhin e perealizuar dikur tanimë e bëri të mundur dhe këtë e arriti falë konsumatorëve laikë.

Tani, meqenëse shumë prej subjekteve hynë në këto kontrata, KEK-u është duke shfrytëzuar këtë mundësi të artë që i është dhënë që, nëpërmjet procedurës përmbartimore, kërkesat e veta të dikurshme ~ **të parashkruara** ~ t'i realizojë, me argumentin se, gjen mbështetje në nenin 29 parag. 1, nënparag. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, si dhe në këto kontrata. Kësisoj, meqenëse tani gjykatat janë duke u përballur me një sfidë të tillë, ku kontestues e kanë faktin e rrjedhjes së

afatit të ri të parashkrimit të kërkesave ekzistuese sipas këtyre kontratave – nëpërmjet këtij punimi, kam bërë përpjekje të hulumtoj dhe të paraqes një sqarim për këto kundërthënie, e për të cilin besoj se do t'u shërbejë jashtë mase gjykatave në aspektin e kognicionit se cili është afati i ri i parashkrimit që rrjedh dhe mbaron për këto kërkesa të jetësuar me këto punë juridike.

Parashkrimi, roli dhe funksioni i tij në raportet kontraktore të së drejtës së detyrimeve, respektivisht në kontratat e hartuara ndërmjet KEK-ut dhe konsumatorëve të saj sipas rregullave të LMD-së

Parashkrimi si institut i së drejtës luan një rol të rëndësishëm në ngritjen e sigurisë juridike ndërmjet subjekteve të së drejtës. Kjo siguri konsiston si në qëndrueshmërinë e rendit juridik, por edhe të asaj që subjektet e së drejtës të jenë të kujdesshme që të drejtat e tyre t'i realizojnë me kohë.

Parashkrimin, ose vjetërsimin si institut të së drejtës e hasim në degë të ndryshme të të drejtave, si p.sh. në të drejtën penale,² në të drejtën e punës,³ në të drejtën administrative,⁴ në të drejtën sendore,⁵ në të drejtën familjare,⁶ në të drejtën e trashëgimisë⁷ e kështu me radhë, por është e rëndësishmja ta përmendim, se fusha ku mund të gjendet më së shpeshti parashkrimi është *E drejta e detyrimeve*. E drejta e detyrimeve është degë pozitive e së drejtës e cila merret me rregullimin e raporteve juridike josubordinuese të subjekteve të së drejtës, pra të raporteve ku, sikurse kreditori, edhe debitori, me vullnetin e tyre të lirë, vendosin të krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një raport juridik të detyrimeve ose,

² Shih: Nenin 106 parag. 1 nënparag. 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 si dhe 1.6, si dhe Nenin 108 parag. 1 nënparag. 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, si dhe 1.6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPK).

³ Shih: Nenin 78 parag. 1, 2 dhe 3, lidhur me Nenin 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

⁴ Shih në të drejtën komparative nenin 84 të Ligjit për Tatimet mbi Pronën në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe nenin 8 të Ligjit Nr. 8846, dt. 11.12.2001, për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 8560, dt. 22.12.199, për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me Ligjin Nr. 8710, dt. 15.12.2000.

⁵ Shih: Nenin 28, 40 dhe 114 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore.

⁶ Më hollësisht shih Ligjin Nr. 2004/32 për Familjen të Kosovës,

⁷ Shih: Nenin 46, 101, si dhe 138 të Ligjit Nr. 2004/26 për Trashëgiminë të Kosovës.

thënë më qartë, të themelimit të të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella mbi bazën e autonomisë së plotë të vullnetit.

Këto raporte ose marrëdhënie juridike, sido që t'i quajmë, kanë afate (*ligjore* ose *kontraktore*), e të cilat afate duhet respektuar para kohës së skadimit të tyre. Ky respektim nënkupton që përmbushja e prestimit të bëhet **në kohë** – si nga pala që ka për detyrim të përmbushjes, por njëkohësisht të kërkohet edhe nga pala që ka të drejtë. Mirëpo, jo çdo herë prestimet (*detyrimet*, *obligimet*) kërkohen dhe përmbushen **në kohë** nga palët. Në këso rrethanash, kreditori, me qëllim që të mos e humbë kërkesën e vet, duhet të jetë i kujdesshëm dhe të drejtën subjektive ta kërkojë brenda afatit, qoftë sipas atij të kontraktimit ose sipas atij që parashihet nga e drejta substanciale e një vendi. Në të kundërtën, pas kalimit të afatit, kreditorit i kufizohet realizimi i të drejtave subjektive, pasi që debitori e fiton të drejtën e kundërshtimit kundrejt pretendimit të tij.

Kur fillon rrjedhja e afatit të parashkrimit ndaj kërkesave të kreditorit?

Sipas LMD-së, rrjedhje të afatit të parashkrimit për kërkesat e kreditorit kemi nga dita e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër (neni 342 parag. 1 i LMD-së). Dhe kur ky afat kalon, atëherë fitohet kundërshtimi, pasi që parashkrimi lind kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj (neni 343 i LMD-së).

Në mesin e parashkrimeve LMD-ja ka sanksionuar një sërë kërkesash që parashkruhen pas kalimit të afatit, po qe se kreditori nuk i kërkon **në kohë** ndaj debitorit.

Të tilla janë p.sh. kërkesat e përgjithshme (5) pesëvjeçare, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit (neni 352 i LMD-së). Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit, ku këtu inkorporohen edhe kërkesat periodike aksesore me afat të parashkrimit (3) trevjeçar (neni 353 i LMD-së); parashkrimi i vetë të drejtës nga të cilat rrjedhin kërkesat periodike në afat prej pesë (5) vjet (neni 354 i LMD-së); kërkesat e qirasë në afat prej tre (3) vjet (neni 356 i LMD-së); kërkesat e shpërblimit të dëmit në kohëzgjatje prej tre (3) vjet (neni 357 parag. 1 i LMD-së); si dhe në çdo rast sipas afatit objektiv në pesë (5) vjet (neni 357 parag. 2 i LMD-së); kërkesat e kompensimit të dëmit të krijuar nga akti i abuzimit me të mitur, të cilat parashkruhen në afat prej (15) pesëmbëdhjetë vjetësh (neni 357 parag. 4 i LMD-së);

kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale me afatin e parashkrimit sipas vetë rrjedhjes së afatit të kohëzgjatjes së ndjekjes penale (neni 358 i LMD-së); kërkesat për dëmet e shkaktuara nga akti i korrupsionit në afat prej (5) pesë vjetëve, sipas afatit subjektiv, si dhe në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vjetëve, sipas afatit objektiv (neni 359 i LMD-së); kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente në kohëzgjatje të parashkrimit prej dhjetë (10) vjetësh (neni 361 paragraf. 1 të LMD-së); kërkesat që rrjedhin nga kontratat e sigurimit në kohëzgjatje të parashkrimit për pesë (5) vjet, kur fjala është për kërkesat e sigurimit të jetës, ndërsa për kërkesat e tjera të sigurimit për tre (3) vjet (neni 362 i LMD-së); kërkesat reciproke nga kontratat komerciale në afat prej tre (3) vjetësh (neni 355 i LMD-së); si dhe kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti (neni 360 i LMD-së).

Qëllimi i këtij punimi është të ndalemi në këtë të fundit, pra në kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti. Për faktin se është edhe tezë e këtij punimi hulumtues. Sipas LMD-së, respektivisht nenit 360 paragraf. 1, kërkesat (*për nevojat konsumuese*) që parashkruhen pas një viti i vlerëson në:

1.1 kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake;

1.2. kërkesat e radios dhe televizionit për përdorimin e stacionit;

1.3. kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate (3) tremujore apo më të shkurtra;

1.4. kërkesat e parapagimit në botime periodike, duke llogaritur nga kalimi i kohës për të cilën është porositur botimi;

1.5. kërkesat për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet për përdorimin e e-mail-it, shërbimet për mirëmbajtjen e "faqes elektronike", dhe shërbimet e lidhura me qasjen në stacionet e radios dhe televizionit kabllor dhe satelitor që arkëtohen në afate (3) tremujore apo më të shkurtra;

1.6. kërkesat nga administratorët e blloqeve të apartamenteve për shërbimet dhe kërkesat e tjera që arkëtohen në afate tremujore apo më të shkurtra.

Ndërsa paragraf. 2, i nenit 360 të LMD-së, afatin e parashkrimit e llogarit nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë; e që, në fakt, nuk duhet të qëndrojë në asnjë mënyrë një qëndrim i tillë juridik

në këtë formë siç proklamohet nga ligjvënësi kosovar, pasi që, nëse bëhet një përlllogaritje e këtillë e afatit, atëherë do të dilte dyfishi i kohës së maturimit të afatit të parashkrimit nga ajo që parashihet sipas nenit 360 parag. 1 të LMD-së. Mirëpo, meqenëse kjo çështje nuk është tezë e këtij punimi, e njëjta është eskivuar nga shtjellimi i mëturjtjeshëm i saj, përkundër asaj që ka nevojë për t'u bërë.

Pra, nga ajo që u konstatua si më lart, kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti, siç janë ato që parashihen me nënparag. 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 si dhe 1.6 të parag. 1 të nenit 360 të LMD-së, janë afate ligjore të cilat nuk mund të ndryshohen, pra mbesin të paprekshme dhe si të tilla duhet respektuar nga çdo subjekt i së drejtës, pa marrë parasysh pozitën e tij/saj në raportet juridike të detyrimeve-kontraktore.

Pas kalimit të këtij afati ligjor, kreditori nuk mund të realizojë më kërkesën e vet në rrugë gjyqësore, me argumentin se kërkesa e natyrës juridike civile shndërrohet në kërkesë të natyrës natyrore. Dhe në këtë aspekt, gjyqtarët kërkesat e njëjta i refuzojnë *in meritum* që në rastin e parë kur të *paditurit/debitorët* thirren në parashkrim (neni 341, parag 3 i LMD-së). Por, kërkesa e parashkruar e kreditorit mund të realizohet nëpërmjet rrugëve gjyqësore ndaj debitorit, vetëm atëherë kur ky i fundit pranon një borxh të këtillë (neni 368 i LMD-së), pa marrë parasysh se a i kupton ose jo pasojat e pranimit.

Krahasimi i kësaj situate me rastin KEK-konsumator?

Analogji të këtillë kemi edhe ndërmjet Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) si dhe konsumatorëve të saj, të cilët këta të fundit borxhin e parashkruar me ose pa qëllim e kanë pranuar. Vlen për t'u theksuar se, në klauzolën e nenit tre (3) të çdo kontrate të këtillë parashihet shprehimisht se: “*Nëse nuk bëhet pagesa në tri (3) këste mujore të njëpasnjëshme, atëherë i gjithë borxhi (detyrimi) i papaguar rikthehet, duke përfshirë edhe ndëshkimet, me përjashtim të borxhit që është shlyer (paguar).*”

Sipas këtyre rasteve debitorëve iu është rikthyer një borxh i cili, dikur, ishte e pamundur të realizohej nëpërmjet rrugëve gjyqësore nga KEK-u, për shkak të kalimit të afatit ligjor (1) njëvjeçar të kërkesës, përkatësisht ***parashkrimit***.

Me ndërprerjen e parashkrimit sipas kontratës, tani ka filluar të rrjedhë afat i ri nga çasti i ndërprerjes së tij, pra këtu nga momenti i hartimit, respektivisht nënshkrimit të kontratës nga ana e palëve (*KEK-konsumator*) konform nenit 373 parag. 1 të LMD-së. Dhe *kohëzgjatja* -

parashkrimi i kërkesës aktuale llogaritet në kohë për aq sa është dashur të parashkruhet kërkesa e mëparshme, përkatësisht mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë (neni 373 parag. 6 i LMD-së).

Shembull:

Nëse kreditori i ofron shërbime të energjisë elektrike, të ujit ose të heqjes së mbeturinave, debitorit për muajin 01.01.2017 e deri më 31.01.2017, afati i parashkrimit sipas qëndrimit tim, por edhe sipas praktikës gjyqësore⁸ (*e jo sipas parag. 2 të nenit 360, që mendoj se është diçka absurde*), fillon të rrjedhë pas momentit të faturimit mujor për kryerjen e këtij shërbimi, pra nga ora: 24:01h, dt. 01.02.2017, e deri më 01.02. të vitit të ardhshëm, me kusht që debitori përgjatë kësaj kohe të mos pranojë, ose eventualisht të bëjë ndonjë pagesë në emër të këtij borxhi mujor, kuptohet jo në tërësi.

Mirëpo, në të vërtetë konfuzioni i gjithë kësaj shtrohet në pyetjen se, në rastin kur kjo kërkesë parashkruhet dhe rilind prapë, atëherë sa e ka afatin e jetëgjatësisë, ose brenda cilës periudhë kohore kreditori ka mundësi ta realizojë të njëjtën, pasi që me krijimin rishtazi të saj nuk duhet nënkuptuar se nuk ka rrjedhje të parashkrimit për një kohë, ose mund të ketë, por ka afate më të shkurtra ose më të gjata (neni 345, parag. 1 dhe 2 i LMD-së) sesa rrjedhja normale e parashkrimit të paraparë sipas ligjit. Kështu, nëse marrim përsëri rastin e mësipërm për faturimin mujor, por tani duke aluduar në kontratë të hartuar më 02.02.2018, për pranimin e borxhit të parashkruar të vitit 01.01.2017 – 31.01.2017, atëherë rrjedhja e parashkrimit për kërkesën e parashkruar dikur, e të ekzistuar tani sipas kontratës fillon përsëri prej datës. 02.02.2018, e deri në ora: 24:00h të datës. 02.02.2019. *A contrario*, kalimi i një sekondi të vetëm (*për të mos thënë të qindat e sekondit*) prej orës 24:00h të datës. 02.02.2019, pa ekzistuar paraprakisht edhe ndonjë procedurë (*gjyqësore*) e filluar nga ana e kreditorit për ndërprerjen e institutit të parashkrimit sipas nenit 369 të LMD-së, si dhe me kushtin e pandashëm që edhe debitori brenda kësaj periudhe kohore (1) njëvjeçare të mos ketë bërë as edhe një pagesë (*përfunduar tërësinë*) të vetme në emër të këtij borxhi të pranuar me kontratë, sjell pas vete pasojat

⁸ Shih: Aktvendimin CML. Nr. 39/2018, dt. 25.06.2018, të Gjykatës Supreme të Kosovës. Si dhe Aktvendimin Ac. Nr. 2737/2018, dt. 18.12.2018, të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

juridike që edhe kjo kërkesë e konstituuar me kontratë të gjendet përpara faktit të ri të parashkrimit.

Tërhiqet vëmendja!

Nuk duhet habitur edhe në rastin kur propozimet përbarimore të kreditorit KEK janë të kundërdrejtuar ndaj debitorëve tregtarë, pra personave juridikë, mbi bazën e faturave – e të mbështetura edhe në këto kontrata që këta të fundit kanë pranuar kërkesat e parashkruara për konsumimin e bërë të energjisë elektrike, pasi që edhe në këtë rast kërkesat kanë po të njëjtin afat të parashkrimit, pra atë (1) njëvjeçar, për të cilin folëm edhe më lart dhe, kështoj, nuk duhet ngatërruar me nenin 355 parag. 1 të LMD-së, ku kjo dispozitë përmban afatin (3) trevjeçar të parashkrimit të kërkesave ndërmjet subjekteve fitimprurëse. Vlen për t'u theksuar se ky afat është krejtësisht i një natyre tjetër dhe aplikohet në mënyra të tjera prej rastit në fjalë, edhe përkundër faktit se subjektet afariste veprimtarinë e tyre e realizojnë për qëllime komerciale, pra profitabile, kur është fjala për konsumimin e *energjisë elektrike, ujit ose heqjes së mbeturinave etj.* Ndaj kërkesave të njëjta aplikohet gjithnjë dispozita e nenit 360 të LMD-së, pasi që këto shërbime përmbajnë mall konsumues sipas nenit 3 parag. 1, nënparag. 1, 9, 29, 31 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit. Nga ky rast do të kishte përjashtim, ose më konkretisht nuk do të aplikohesh neni 360 i LMD-së, por do të aplikohesh dispozita e nenit 355 parag. 1 të LMD-së në llogaritjen e afatit (3) trevjeçar vetëm atëherë kur debitori, në cilësinë e personit juridik, këto shërbime të pranuar nga furnizuesi i autorizuar i bën për motive komerciale, pra duke shpërndarë te personat e tretë, ose për qëllime të tjera ekonomike që nuk hyjnë në kuadrin e konsumit normal që e bën një konsumator i rregullt pa marrë parasysh se a është person fizik ose juridik.

Kështu, në momentet kur gjykatat e faktit përballen me prapësime të debitorëve, sikurse të personave fizikë, e po ashtu edhe të personave juridikë që i kanë ushtruar ndaj urdhrave përbarimorë të lëshuar nga Përbaruesit Privatë, e me të cilat janë caktuar (*lejuar*) propozimet përbarimore të kreditorit KEK për këto borxhe, më saktë kërkesa të pretenduara nga kjo e fundit, sipas këtyre rasteve, gjykatat, respektivisht gjyqtarët, duhet të jenë të kujdesshëm në bërjen e vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si dhe në aplikimin e drejtë të së drejtës materiale, pasi që ka mundësi që edhe këto kërkesa të kenë ka-

luar po këtë afat ligjor (1) njëvjeçar dhe atë pasi që fillimisht ta vërtetojnë faktin se kreditori më parë nuk ka inicuar ndonjë procedurë gjyqësore për ndërprerjen e këtij afati, për të kaluar më pastaj në atë se debitorët (*personat fizikë ose juridikë*) mos kanë bërë eventualisht ndonjë pagesë përgjatë kësaj periudhe kohore, e tek pas kësaj për çdo rast konkret duke vepruar në mbështetje të neneve 373 parag. 1, ekskluzivisht 6, lidhur me nenin 352, konform nenit 360 parag. 1 me nënparagrafët e tij, si dhe në mbështetje të *analogia iuris* sipas nenit 361 parag. 2 të LMD-së.

PËRFUNDIM

Nga ajo që u tha si më lart lidhur me parashkrimin, theksuam se ky institut i së drejtës në çdo marrëdhënie juridike të së drejtës shërben si siguri juridike për subjektet e së drejtës sa i përket aspektit të kriterit kohor. Parashkrimi ka rëndësi të marrëdhëniet juridike, respektivisht në të drejtën e detyrimeve pasi që është një thirrje që palëve ua bën me dije se të drejtat e tyre duhet t'i kërkojnë me kohë. Kjo kohë ka limitet e veta, qofshin ligjore ose kontraktore, e të cilat duhet respektuar nga palët. Një gjë e tillë nuk ishte respektuar edhe nga KEK-u, kur kërkesat e veta ndaj konsumatorëve nuk i kishte parashtruar me kohë për borxhet që këta të fundit i kishin për konsumimin e energjisë elektrike të bërë. Mirëpo, sipas një veprimi të mençur, falë edhe Qeverisë të z. Mustafa, (*aso kohe kryeministër*), u nxor një ligj, i cili nxiti jashtë mase çdo kënd që të hynte në kontrata të shlyerjeve të borxheve, që veçse ishin inekzistente në pikëpamjen ligjore.

Këto kontrata të hartuara prodhuan efekte juridike si të ndërprerjes së afatit të rrjedhur të parashkrimit, po ashtu edhe në fillimin e një afati të ri të parashkrimit nga ai i kaluari.

Me rrjedhjen e re të parashkrimit, kërkesa e dikurshme e parashkruar e KEK-ut tashmë gëzonte mbështetje ligjore dhe atë për shkaqet e paraqitura si më lart.

KEK-u, duke pretenduar tani se kërkesat e veta nuk janë më të parashkruara, ka filluar që t'u adresohet me *kërkesa/propozime* zyryave të Përmbaryesve Privatë, për të aprovuar të njëjtat në mënyrë që të realizojë të drejtat përkarshi detyrimeve të qytetarëve dhe bizneseve.

Pas lëshimit të urdhrave përmbarymorë nga Përmbaryesit Privatë, gjykatat po përballen me shumë prapësime të debitorëve, të cilat po

korrespondojnë me një ndërlikueshmëri të fakteve sebsi duhet nënkuptuar tani afati i ri i parashkrimeve. Andaj, duke qenë se gjyqtarët janë duke u përballur me dilema të tilla, lidhur me atë se si duhet bërë llogaritja e afatit të ri të parashkrimit të filluar sipas këtyre kontratave, ky fakt: *konfuzitet si dhe gërshetim i afateve*, më ka stimuluar për realizimin e këtij punimi, e për të cilin dëshiroj të besoj se ka paraqitur një shtjellim të thelbit për dilemën në fjalë, si dhe është ofruar sadopak një zgjidhje oportune për çdo gjykatë të faktit në Kosovë, që në momentin kur pranojnë lëndë civile-përmbartimore, ta kenë si udhërrëfyes të kuptimit të këtij afati të ri kohor të parashkrimit.

Conclusion

The above explanation of the prescription, we emphasized that this institute of law in every juridical relations of the law serves as legal certainty for the legal entities regarding the aspect of the time criterion. Prescription matters to legal relation, respectively on the right of obligations as it is a call that lets parties know that their rights should be sought on time. This time has its limits, whether being legal or contractual, which shall be respected by the parties. This was not respected even by KEC, when its requests to customers had not filed in due time for the debts of the latter had to consume electricity. However, according to an intelligent action, thanks to the Government (at that time), Mr. Mustafa, who was prime minister, issued a law that urged everybody to enter into debt write-offs that were already inexistent in the legal perspective.

These contracts produced legal effects such as termination of the statutory limitation period, as well as the start of a new statutory limitation period.

Upon the new statutory outflow, KEC's former statutory requirement was already legally supported and the reasons set out above.

KEC, now claims that its requirements are no longer prescribed, has begun to address requests / proposals to the Private Enforcement Agents offices to approve them in order to realize the rights to the obligations of citizens and businesses.

Following the bailiffs' execution orders by Private Enforcement Agents, the courts are facing many turndowns of the debtors, which are corresponding to the complexity of the facts about how the new limitation period should now be implied. Therefore, since judges are facing

such dilemmas as to how to calculate the new statutory limitation period initiated under these contracts, this fact, confusion as well as scaling of deadlines, has stimulated me to take this as a paper which I would like to believe has presented the fundamental essence of the dilemma in question and is offered an opportune solution to every court of fact in Kosovo that, as soon as they receive civil-execution cases, have them as a guide to the meaning of this new deadline for statutory limitation.

Recensent

Prof. dr. Kadri Kryeziu

Prof. dr. Muharrem Faiku

Bibliografia

a. Ligjet e aplikueshme

Kodi Penal i Republikës së Kosovës;

Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve;

Ligji Nr. 04/L-139 i Procedurës Përmbartimore;

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës;

Ligji Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike, si dhe Ligji Nr. 05/L-119 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike;

Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore;

Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës;

Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgiminë i Kosovës;

Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit;

Ligji për Tatimet mbi Pronën në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

Ligji Nr. 8846, dt. 11.12.2001, për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 8560, dt. 22.12.1999, për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me Ligjin Nr. 8710, dt. 15.12.2000.

b. Praktika gjyqësore

Aktvendimi CML. Nr. 39/2018, dt. 25.06.2018, i Gjykatës Supreme të Kosovës;

Aktvendimi Ac.Nr. 2737/2018, dt. 18.12.2018, i Gjykatës së Apelit të Kosovës.